



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:212577

Datë: 30.11.2020

Numri i dokumentit: 01305387

P.nr.1018/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.R., me vendbanim në Rruga e “..... ” në Ferizaj, për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1513-1/2019 te datës 24.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datën 18.11.2020, në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurores së shtetit Ajtene Zoni, të dëmtuarës L.R. dhe të akuzuarit I.R., më datën 19.11.2020, mori dhe publikisht shpalli, kurse me shkrim e ka hartuar me datën 30.11.2020, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **I.R.**, me vendbanim në Rruga e “..... ” në Ferizaj, i lindur më, nga i ati dhe e ëma, e gjinisë, i gjendjes së mesme ekonomike, pensionist, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. Personal, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

-Me datën 12.08.2019, rreth orës 14:00,në Rruga e “..... ” në Ferizaj i pandehuri ka ushtruar në mënyrë arbitrare të drejtën që ka mëndu se i takon në vend se ti drejtohet organit kompetent, ashtu që i pandehuri me një mjet-kazme, i kishte hequr një krah te dyerve pronë e të dëmtareve F.R. dhe L.R. të cilat ishin të vendosura në rrugë-hyrje për në oborrin e shtëpisë së dëmtarëve, duke pretenduar se prona i takojnë atij,-

- **Me këtë ka kryer veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 1 të KPRK-së**

Andaj gjykata në bazë të dispozitës të sipërcituar dhe neneve 4,7, 17, 38, 46, 47, 48, 49, 69, të KPRK-së si dhe nenit 365,450 dhe 463 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N

Të akuzuarit **I.R.**, i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 / katër / muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

Të dëmtuarit F.R. dhe L.R., me vendbanim në Rrugën e “..... ” në Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Të akuzuarin I.R. gjykata e ka liruar nga pagesa e paushallin gjyqësor dhe taksa për Kompensimin e viktimave të krimit pasi ka dal në pension, nëse e obligonte që të paguaj dhe taksën do të rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit ose të personave që ai detyrohet të i mbështes materialisht.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr.1513-1/2019 te datës 24.09.2019, ka akuzuar I.R., me vendbanim në Rruga e “..... ” në Ferizaj, për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të gjitha provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 18.12.2019, konform nenit 246 të KPPK-së të pandehurin I.R., e ka udhëzuar për të drejtat e tij dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, dhe atij i ka dhënë mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, dhe përkitazi me këtë i akuzuari është deklaruar i pafajshëm.

I pandehuri I.R., nuk e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin dhe mbrojtësit e tij se para shqyrtimit të dytë mundë të paraqes kundërshtim kundër provave si dhe kërkesa për hedhjen e aktakuzës, këtë konform nenit 249 dhe 250 KPPK-së.

I pandehuri I.R., në gjykatë me datën 16.01.2020, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, ka sjellë kërkesë për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale.

Gjykata me dt.21.01.2020, një ekzemplar të kërkesës për hedhjen e aktakuzës ia ka dorëzuar Prokurorisë Themelore Ferizaj-Departamenti Penal i Përgjithshëm-prokurorit të shtetit, ku ka kërkuar nga prokurori i shtetit që të përgjigjet me shkrim lidhur me kërkesat e parashtruar nga palët e lartë cekuar që gjyqtari i vetëm gjykues ti mundësohet që të merr

aktvendim me shkrim për të gjitha kërkesat e pazgjedhura para shqyrtimit gjyqësor konform nenit 254 par.6 të KPPK-së, por prokurori i shtetit edhe pas pranimit nuk ka dhënë përgjigje me shkrim.

Gjykata mbështetur në nenin 250 par.3 të KPPRK-së me datën 03.02.2020 ka vendosur lidhur me kërkesën e të akuzuarit I.R. dhe me aktvendim ka refuzuar si të pa bazë kërkesën për hedhjen e aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1513-1/2019 të datës 24.09.2019, në këtë fazë mendon se ofrohet mundësia për shqyrtim të gjithanshëm gjyqësor në këtë çështje penale, përmes të cilit do të jepet mundësia e shqyrtimit të provave të propozuara nga ana e Prokurorit të Shtetit, dëgjimit të dëmtarëve F.R. dhe L.R. dhe provave të tjera që gjinden në shkresat e lëndës, shikimi i Videoinqizimet –CD-së, shqimin e fotografive dhe dëgjimit të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar asnjë prove dhe pa predikuar epilogun përfundimtar të këtij gjykimi.

I akuzuari I.R. në afatin ligjor kundër Aktvendimi mbi refuzimin e kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave ka ushtruar ankesë për gjykatën e Apelit të Kosovës.

Gjykata e Apelit të Kosovës ka marrë Aktvendim PN.nr.217/2020 me datën 04.05.2020, ku ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e të akuzuarit I.R. të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1018/19 i dt.03.02.2020.

Gjykata me datën 18.11.2020 në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin kryesor, ku përsëri ka ftuar të akuzuarit të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 par.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Prokurorja e shtetit Ajtene Zoni përsëri edhe në shqyrtimin kryesor të akuzuarit i ka lexuar aktakuzën dhe pas leximit gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe i ka ofruar mundësi të deklarohej mbi fajësinë apo pafajësinë lidhur me veprat penale për të cilat akuzohen.

I akuzuari I.R., nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pasi i akuzuarit nuk e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka ftuar prokurorin e shtetit për të përmbledhur provat që mbështesin rastin konform nenit 328 par 1. të KPPRK-së.

Konform nenit 329 të KPPRK-së gjykata ka bërë prezantimin e provave që i ka konsideruara të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.

E dëmtuara L.R., në shqyrtimet gjyqësore ka deklaruar se është e vërtetë se unë jetoj me shtëpi afër me axhën tim që është prezent në cilësinë e të akuzuarit I.R., por rrugën e kemi të përbashkët për të hyrë në shtëpitë tona, dhe është e vërtetë se kanë qenë të vendosura dyert e metalta në rrugë për të shkuar në shtëpi. Me datën 12.08.2019 I.R. e ka hekur një pjese

të krahut të derës së oborrit, unë me qe isha duke punuar kur jam kthyer në shtëpi kam leshur kamerën për të vërejtur se kush e ka hequr derën e oborrit kam vërejtur se I.R. ka përdorur një mjete të fort – kazme dhe e ka hequr derën, pas tërheqjes së derës nga ana e I.R. it pas disa ditë pasi jemi konsultuar me axhën tim F..... kemi marruar veprime që ta kthejmë këtë pjesë të heqjes të derës në vend të vetë, unë kam qenë prezent kur axha im F..... me djalin e axhës së tjetër A.R. kanë dashur ta vendosin derën, por I.R. ka ardhur dhe ju ka thënë ju nuk guxon ta vendosin këtë krah të derës së nëse e vendosin unë do e heqë prapë, dhe ju nëse e vendoseni unë përsëri do ta heqë, e unë menjëherë kam marrë veprim në këtë drejtim dhe e kam njoftuar policinë, ku policët kanë ardhur në vend ngjarje ku për këtë kame dhen deklarata në polici. Në vazhdim e dëmtuara në pyetjen e prokurores së shtetit deklaroi se me çfarë arsyeja e ka larguar derën unë nuk e di, unë e di se baba ime tani i ndjeri I.R. i ka vendosur këto dyer, por me kujtohet se axha ime M.R. me ka thënë se kur janë vendosur këto dyer ka qenë prezent edhe I.R., por deri me tani që po deklaroj ende nuk janë të rregulluar dyert - krahu i derës që e ka hequr I.R., ku për këtë është zhvilluar procedurës civile e pasi ka ankesë jemi duke pritur vendosje nga gjykata e Apelit në Prishtinë pasi e di mirë se patundshmëria ku janë të vendosura dyert e oborrit është e axhës tim F.R..

Në shqyrtimin gjyqësor nuk është prezent i dëmtuari F.R. nga fletkthesa është konstatuar se pala gjendet jashtë vendit, edhe pse gjykata me datën 27.10.2020 ka leshur urdhëresë për verifikim për vend ndodhjen e tij por ende nuk është njoftuar zyrtarisht, por e dëmtuara L.R. dhe i akuzuari I.R. theksojnë se F.R. gjendet jashtë vendit konkretisht në shtetin e Norvegjisë.

Konform nenit 388 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së, lexohet Procesverbali ku ka deklaruar i dëmtuari F.R. e datës 14.08.2019 dhen në zyrën e Sektorit të Hetimeve në Stacionin Policor në Ferizaj ku ka deklaruar se me datën 12.08.2019, rreth orës 10:00 h, deri sa ishte në oborrin e vëllait të tij tani të ndjerit I.R., dhe ishte duk i prerë një gardhë me kërkesë të vajzës së tij, pa pritur aty ka ardhur vëllai tjetër I.R. me një kazme në dorë dhe përnjëherë e ka goditur derën e oborrit të cilën e dëmtoi dhe pastaj ka hyrë në oborr dhe e ka kërcënuar duke më thënë që mos gabo që ta vendosësh derën më këtu, pastaj edhe më share dhe ofenduar me fjalët banale duke tentuar të më nxitë me qëllim që unë të reagoj dhëta godas apo diçka tjetër. I.R. i atë ditë për afërsisht dy orë ka qëndruar në oborr duke më share dhe ofenduar ku prezent ka qenë edhe vëllai imë i madh M.R. dhe djali i tij V.R., dy orë më vonë I.R. u larguar nga aty dhe pasi u qetësua pak i kam njoftuar policinë për rastin në fjalë.

Në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor: Lexohet dhe shikohet Aktgjykim me numër të lëndës C.nr .520/16. të datës 27.02.2017; Lexohet dhe shikohet videoinqizimi-CD si dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde penale.

I akuzuari I.R., në shqyrtimin gjyqësor në mbrojtjet e dhënë ka deklaruar se prona ime me F.R. nuk kufizohet, por rruga është e gjatë 30 m dhe e gjerë 4 m, ku vërtetohet edhe me skicat e matjes e para është skica me 04.08.2016 të cilën e ka leshura Gjykata Themelore Ferizaj kemi edhe skicën tjetër ku shihet në skicë e punuar nga gjeometri R.A. i datës

15.11.2016, po ashta edhe ne skicën e datës 26.09.2016, e kemi edhe skicën e gjeodetëve te matjes të datës 11.10.2016 dhe e fundit e skicës datës 13.12.2019 e punuar nga S.P., te gjitha këto skica te përmendura janë te punuar për parcelën numër 1210/2013 e ZK –Ferizaj ne emër te I.R. te cilën e kam dëshmi edhe nga kontrata e shitblerjes, është e vërtetë se ka pasur te vendosur dyer dhe këto dyer janë te vendosur ne vitin 2016 rrugën te cilën e shfrytëzojnë te dëmtuarit, por për atë që akuzohem se e kam hequr një krah të derës nuk e kam hequr andaj nuk e ndiej vetën të fajshëm për veprën penale që akuzohem.

Prokurorja e shtetit Ajtene Zoni në fjalën përfundimtare bëri përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës dhe atë në rreshtin e tretë ku thuhet: “ i kishte hequr dyert “, duhet të jetë: “ e kishte e hequr një krah te dyerve, ndërsa pjesa tjetër e dispozitivit të aktakuzës mbetet e pandryshuar.

Në vazhdim prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar: gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor pas administrimit të gjitha provave në këtë çështje penale në mënyrë të plotë është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, pasi me i me dëgjimin e të dëmtuarës L.R. dhe leximit të deklaratës së të dëmtuarit F.R., shqimit të Vidiinqizimit-CD-së dhe fotove që gjinden në shkresat e lëndës i u vërtetua plotësisht gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, dhe te njëjtit ti shqiptoj demin penale te paraparë me ligje.

E dëmtuara L.R. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, i bashkëngjitëm ndjekjes penale, ku kërkesën pasurore juridike do ta realizojmë në kontest të rregullt civil.

I akuzuari I.R. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: nuk e nde veten te fajshëm për veprën penale qe akuzohem ,sepse nuk e kam kryer ketë vepre penale, sepse prokuroji ne ketë çështje penale nuk ka as një prove as me video as me as gjë qe unë e kam hequr derën , dera për et cilën akuzohem ka qen e dëmtuar jo nga unë por nuk e di nga kush është dëmtuar, derën është lëvizura vazhdimisht jo nga unë , kane marr veprime ta vendosin derën por kjo do te e vendoset vetëm me vendim gjykatës andaj ne baze te kësaj nuk e ndie veten te fajshëm. Por edhe njehur deklaroj se dera ka qen e vendosur pran vendit ku ka qen e vendosur, por shpesh ju është ndërruar vendi, kjo dere është kapur krahu i majtë i kapur për shtyllë d.m th ka qen , ne shtyllën e cila është vendosur ne oborrin tim .

Gjykata duke u bazuar në nenin 7 ,8 dhe nenin 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së vlerësoi provat një nga një dhe të gjitha së bashku si dhe lidhje me provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale në tersi vërtetoi këtë gjendje faktike : se me datën 12.08.2019, rreth orës 14:00,në Rruga e “..... ” në Ferizaj i pandehuri ka ushtruar në mënyrë arbitrare të drejtën që ka mëndu se i takon në vend se ti drejtohet organit kompetent, ashtu që i pandehuri me një mjet-kazme, i kishte hequr një krah te dyerve pronë e të dëmtareve F.R. dhe L.R. të cilat ishin të vendosura në rrugë-hyrje për në oborrin e shtëpisë së dëmtarëve, duke pretenduar se prona i takojnë atij.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e të dëmtuarit L.R., leximit të deklaratës së të dëmtuarit F.R. shikimit të videoinqizimit-CD-së, shikimit të fotografive që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale.

Gjykata i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi i plotë provave të propozuara nga prokurori i shtetit, të cilat në tërësi vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, pasi që të gjitha provat e prezantuara në shqyrtim janë bindëse dhe të qarta e gjithashtu janë në harmoni me dëshmitë e dëmtarëve të cilëve gjykata iu fali besimin si dhe me provat e tjera materiale.

Gjykata gjithashtu vlerësoi edhe e mori në konsideratë edhe mbrojtjen e të akuzuarit I.R., por e ka refuzuar si të pabazuar, e cila është në kundërshtim të plotë me gjendjen e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës, dhe se e njëjta është e orientuar nga shmangia e përgjegjësisë penale-juridike me vetë faktin se me deklaratën e të dëmtuarës dhe të dëmtuarit dhe shikimit të CD-së në shqyrtim gjyqësor në prezencën e të gjitha palëve dhe provat tjera të administruara në seancën e shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar e kundërta, e gjithashtu i njëjti para kësaj gjykate nuk ka mundur që të dëshmojë me asnjë provë materiale pafajësinë e tij.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rrethanat e vërtetuara, në shqyrtim gjyqësor, si dhe dëshmitë e dhëna. Të gjitha këtyre provave kjo gjykatë u kushtoi besim të plotë, e të cilat qojnë gjykatën në konkludim se besueshmëria në to dhe shkalla e arsyeshmërisë së deklarimeve me rrethanat konkrete të rastit, nuk lënë vend për dyshim, prandaj gjykata gjen se në anën e akuzës ka prova që në mënyrë të padyshimtë të vërtetojnë që i akuzuari të ketë kryer veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 418 par 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 69 të KPRK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, është i moshuar, në pension, prindër i 2 (dy) fëmijëve, , sjellja e tij korrekte në gjykim, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i njëjti është dënuar edhe me pare sipas aktgjykimit P.nr.2188/17 të datës 02.07.2018, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-së ku e dëmtuar është e njëjta palë L.R., andaj gjykata ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale me bindje se me këtë lloj të dënimit, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 463 parag.1 lidhur me par 2.të KPPK-së , të dëmtuarit F.R. dhe L.R., me vendbanim në Rrugën e “..... ” në Ferizaj

Konform nenit, 453 par 4 të KPPRK-së të akuzuarin e ka liruar nga pagesa e paushallit gjyqësor dhe pagesa e Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.1018/2019 me datë 30.11.2020

Zyrtare Ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.